



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.07.2023*

nr.408, datë 23.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese. Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 10 (dhjetë), z. Arkend Bashkim Balla. I cili ka plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numrin unik 20. Nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatis për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Arkend Bashkim Balla, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatis në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë vendosim dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatis të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, z. Arkend Bashkim Balla.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.07.2023*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendimi nr. 693.**

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.07.2023*

12.07.2023

Ora 12:11

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidatin nga lista shumemërore të Koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë”, zj. Zamira Xhevat Mernica”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**  
2. Stafi KQZ:    **Z.Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**

• **Parti Politike:**

- **Të tjerë:**    **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Atëherë, vazhdojmë me plotësimin e vakancave për disa bashki, relatoj për të gjitha bashkitë.

**Z. Y. Merkaj:**Bashkia Fier, Bashkia Skrapar, Bashkia Pogradec, Bashkia Selenicë, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Mallakastër dhe Bashkia Klos, kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vakancat në këshillat e tyre përkatëse. Nga kandidatët e listave shumemërore të cilët ju kalon mandati i këshilltarëve kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit ku nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se asnjë prej kandidatëve nuk ka deklaruar të dhënat që kanë të bëjnë me ndalimet në ligjin nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacione nga zyra e gjendjes civile

**Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.07.2023*


dhe zyra gjëndjes gjyqësore për të gjithë këta kandidatë. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Gjëndjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjëndjes gjyqësore për të gjithë kandidatët ku konstatohet se asnjë prej tyre nuk është denuar me vendim penal të formës së prerë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar të dhënat e kandidatit të ndryshëm ku konstatohet se vetëm një kandidat ka bërë ka nfrushuar mbiemrin kandidati i Mallakastrës nga Neziraj në Hoxhaj. Në këto kushte në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e të gjithë kandidatëve për anëtar, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit në këshillat përkatës. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Për sa bashki ishin këto?

**Z. Y. Merkaç:** Për 8, Bashkia Pogradec është dy herë.

**Z. I. Celibashi:** Mirë atëherë, vendosim plotësimin e vakancës për Këshillin Bashkisë Fier me kandidatin nga lista shumemëore e Koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë” zonjës Zamira Mernica. Plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Skrapar nga lista shumemëore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë” me zotin Erald Zaimi. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pogradec me kandidatin nga lista shumemëore të Partisë Demokratike të Shqipërisë zonjën Alketa Bega. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pogradec nga kandidatit nga lista shumemëore të Partisë Demokratike të Shqipërisë zoti Engjell Fluturak Shyti. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë me kandidatin nga lista shumemëore të

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.07.2023*

Partisë Socialiste të Shqipërisë Mene Osmënaj. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë me kandidatin nga lista shumemërore të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” zonjën Lije Dedej. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet zonjës Zhaneta Shezahi Hoxhaj. Plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Klos me kandidatin nga lista shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë zoti Eduard Hoxha.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.07.2023*

12.07.2023

Ora 12:14

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për akreditimin e vëzhguesve jopolitikë përmes platformës elektronike të vëzhguesve, në zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, të datës 23 Korrik 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Staf i KQZ:    **Z.Y. Merkaç, Znj. P. Doçaj**

• **Parti Politike:**

• **Të tjerë:**    **KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Atëherë, vazhdojmë me pikën fundit që ka të bëjë me projektvendimin për akreditimin e vëzhguesve jo politikë nëpërmjet platformës elektronike të vëzhguesve për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë për datën 23 Korrik 2023.

**Z. Y. Merkaç:** Në mbështetje të nenit 6 dhe 7 e 19, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit në zgjedhje nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, kemi përgatitur projektvendimin për akreditimin e vëzhguesve jo politikë përmes platformës elektronike të vëzhguesve për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, të datës 23 Korrik 2023. Në zgjedhjet e datës 23

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.12.07.2023*

Korrik për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë do të përdoret projekti pilot për akreditimin e vëzhguesve përmes platformes elektronike, portali i vëzhguesve është një sistem ndërveprues për regjistrimin dhe administrimin e vëzhguesve jo partiak në zgjedhje qëllimi dhe implementimi i një platforme të tillë lidhet kryesisht me mundësinë që do ti jepet organizatave jo qeveritare shqiptare dhe të huaja, përfaqësues të medias të specializuar për vëzhgimin e zgjedhjeve. Të cilët do të paraqesin dokumentacionin e kërkuar konformë Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore për tu regjistruar në rolin si vëzhgues vendas apo vëzhgues ndërkombëtar gjatë periudhës zgjedhore. Dokumentacioni do të plotësohet dhe ngarkohet në platformën elektronike nga organizatat jo partiake. Ky dokumentacion do të administrohet dhe vlerësohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në një platformë tjetër teknologjike duke e bërë procesin më të shpejtë dhe më efektiv. Gjithashtu pjesë përbërëse e këtij projektvendimi është edhe moduli , i cili shpjegon procedurat e akreditimit dhe mënyrën e përdorimit të kësaj platforme nga vëzhguesit jo partiak. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe manualin e përdorimit për portalin e vëzhguesve.

**Z. I. Celibashi:** Miratojmë projektvendimin për akreditimin e vëzhguesve për zgjedhjet e datës 23 Korrik 2023 nepërmjet projektit pilot përdorimit të platformës elektronike të regjistrimit dhe akreditimit të vëzhguesve sipas draftit të propozuar. Çështje të tjera nuk kemi, seanca mbyllet. Ditë të mbarë!

**Vendimi nr.702**

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*

